



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

Data	19.09.2025	Vendi	Kaçanik
Nj. org.	Numri	Shitja	
08-320/01-23714/25			

Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë

NJOFTIM

Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari njofton fermerët e komunës së Kaçanikut për aplikim, në projektin, "Mbështetja e fermerëve me mekanizëm bujqësor": freza 1.6m për tërheqje me traktor, makina kositëse rrotative (me pjator), makina mbledhëse të sanës me rrypë dhe pllugj për tërheqje me traktor.

Në këtë projekt do të përkrahen fermerët me mekanizëm bujqësor të cekur më lartë.

Kushtet e aplikimit:

Aplikuesit duhet ti plotësojnë kriteret si në vijim:

- Të jetë banor i komunës së Kaçanikut.
- Të posedoj sipërfaqe të tokës bujqësore, (lavërtare) minimumi prej 1.50 ha, për kultivimin e kulturave bujqësore.
- Prona të jetë në emër të aplikuesit, prindit apo tokë e marrë në shfrytëzim, për token e marrë në shfrytëzim aplikuesi duhet të posedoj kontratën e noterizuar, të nënshkruar nga qiradhënësi dhe qiramarrësi, në kohëzgjatje prej pesë vitesh në shfrytëzim.
- Fermeri të jetë i gatshëm të participoj 20% vlerës së mekanizmit për të cilin aplikon dhe të posedoj traktorin për tërheqje.

Përparësi:

- Aplikuesit të cilët nuk janë përfutues të më hershëm të ndonjë subvencioni komunal apo përkrahje tjetër dhe që nuk posedojn mekanizëm që ne do ti mbështesim.
- Familjet që merren me bujqësi, e që nuk kanë të punësuar.
- Fermerët që punojnë tokën bujqësore dhe janë aplikues në projektet e subvencionimit të MBPZHR.

Afati i aplikimit: 22.09 2025 deri më 10.10.2025

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Formulari për aplikim
- Kopje e dokumentit identifikues
- Çertifikata e tokës (fleta poseduese)
- Numrin identifikues të fermerit (NIF)

Të interesuarit për më shumë informata mund të drejtohen në zyrat e DBZHRP-së kati parë, në objektin e Administratës Komunale.



Drejtori i DBZHRP

Suhad Dullóvi